

Letër për prindër Nr.1

Të nderuar zonja dhe zotërinj, të dashur prindër,

së bashku me stafin mësimdhënës, ne, zonja Hausner dhe unë, dëshirojmë t'ju mirëpresim ngrohtësisht të gjithëve në vitin e ri shkollor. I urojmë të gjithë fëmijëve dhe juve një fillim të mbarë të vitit shkollor 2021/2022 dhe shpresojmë që të keni pasur pushime të këndshme.

Edhe këtë vit shkollor i gëzohemi një bashkëpunimi harmonik dhe të suksesshëm për të mirën e fëmijëve tuaj, andaj ju lutemi që të punoni me ne përsëri me plot besim. Drejtoresha e shkollës si dhe stafi mësimdhënës janë gjithmonë të gatshëm të flasim me ju. Në shumicën dërrmuese të rasteve problemet, paqartësitë ose keqkuptimet mund të zgjidhen më së shpejti duke folur së bashku.

Meqenëse jemi një "shkollë me profil inkluziv", ne do ofrojmë edhe këtë vit shkollor orë mësimore shtesë, nga të cilat do të përfitojnë fëmijët që kanë nevojë për mbështetje shtesë.

1. Ndryshimet e stafit mësimdhënës:

Për shkak të largimit dhe transferimeve të mësimdhënësve në fund të vitit shkollor (Zonja Kronfeld, Zonja Baumgarten, Zonja Turap, Zonja Fink, Zonja Klaus, Zonja Kappes), ne kemi disa mësimdhënës të ri:

Mësimdhënës shtesë: Zonja Buchner

Mësimdhënës praktikant: Zonja Isabella Blank dhe Zonja Veronika Held

Edukim teknik dhe figurativ: Zonja Mark

2. Mësim zgjedhës/ Mësim shtesë / Mësim lidhës

Për shkak të situatës me virusin korona, fillimisht nuk do ofrohet mësim zgjedhës. Sidoqoftë, ishte e mundur të krijoheshin një numër i madh i kurseve shtesë dhe të ashtuquajturit "mësimet lidhëse" në mënyrë që të kompensohet çdo deficit mësimor që u shfaq në vitin e kaluar shkollor për shkak të mbylljes së shkollës apo mësimdhënies së kufizuar.

Kujdestaret e klasës do t'ju kontaktojnë nëse fëmija juaj është caktuar për këtë mësim.

E RËNDËSISHME: Ju do të merrni një fletë regjistrimi për mësimin shtesë. Orari i mësimin shtesë është i shkruar në fletën e regjistrimit. Mësimi shtesë do fillojë në javën e ardhshme. Ju lutemi të informoni qendrën e kujdesit të fëmijëve pas shkollës dhe shërbimin e transportit të fëmijës tuaj.

3. ESIS:

Nëse keni marrë një e-mail përmes ESIS, ju lutemi gjithmonë të klikoni në "përgjigje/antworten" dhe "dërغو/senden". Përndryshe, ne nuk do të marrim konfirmimin e leximit. Faleminderit!

Ne ju kërkojmë urgjentisht të regjistroheni në ESIS (nëse nuk e keni bërë deri tani), pasi kjo është mënyra më e shpejtë për të marrë informacione të rëndësishme nga shkolla si për shembull në rast të mbylljes së shkollës.

4. Kujdesje në mëngjes:

Fillimisht nuk ka kujdesje në mëngjes, për arsye të mos përzjerjes të nxënësve në oborr të shkollës ose në shkollë. Nëse është e mundur, ju lutemi dërgoni fëmijën tuaj në shkollë në mënyrë që ai/ajo të mos jetë në ambientet e shkollës para orës 7:45 të mëngjesit.

5. Në rast se fëmija juaj është i sëmurë

Në rast se fëmija juaj është i sëmurë, ju lutemi kontaktoni shkollën **deri në ora 8:00** në numrin e telefonit **08131/754960** ose lajmrojeni fëmijën tuaj të sëmurë përmes **ESIS**. Ju lutemi të flisni në voicemail nëse nuk lajmërohet dikush në sekretari. Zyra e sekretarisë është shpesh e zbarzët para orës 7:30.

Meqenëse shpesh shumë fëmijë mungojnë, duhet shumë kohë që sekretarja jonë të thërrasë të gjithë ata që nuk kanë mungesë të justifikuar. Ajo nuk mund ta bëjë këtë në orët e fluksit të mëngjesit. Sidoqoftë, shkolla duhet të jetë e sigurt që fëmijës nuk i ka ndodhur diçka gjatë rrugës për në shkollë nëse mungon. Ju lutemi gjithashtu tregoni llojin e ftohjes/sëmundjes, pasi ka shumë ftohje/sëmundje të cilat duhen lajmëruar.

6. Mbyllja e derës së shkollës

Për arsye sigurie, të gjitha dyert e ndërtesës së shkollës (hyrja kryesore dhe salla sportive) mbyllen në orën 8:00 të mëngjesit. Kushdo që vjen pas kësaj kohe duhet të shtypë zilen në hyrjen kryesore. Kalimi në shkollën e mesme nuk mund të përdoret si hyrje.

Ju lutemi qëndroni para ziles derisa dikush të përgjigjet.

Një lutje për të gjithë prindërit: shoqëroni fëmijën tuaj vetëm deri te hyra e ndërtesës së shkollës. Kjo vlen edhe për fëmijët e klasës së parë - kjo është mënyra e vetme që të funksionojë koncepti ynë i sigurisë dhe higjienës. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj.

7. Sjellja në rrugë apo trafik:

Ju lutemi mësoni fëmijën tuaj se si të silltet saktë në rrugë apo trafik dhe jepni një shembull të mirë. **Mos** e ngisni makinën deri para shkollës. Në atë mënyrë ju rrezikoni fëmijët e tjerë të shkollës. **Ju lutemi sigurohuni që t'i përmbaheni ndalimit absolut të parkimit para hyrjes kryesore - kjo është arsyeja e kontrolleve të shpeshta policore.** Për hir të sigurisë së tyre, fëmijët duhet të shkojnë me biçikletë në shkollë vetëm pas testit të biçikletës në klasën e katërt. Këto duhet të sigurohen me një zinxhir të vedni i parkimit të biçikletave. Skuterët e qytetit gjithashtu duhet të jenë të lidhur me zinxhirë atje. Nuk lejohet të hyhet me ato në shkollë.

8. Ndhmësit e rrugës së shkollës:

Ne i falenderojmë të gjithë ndhmësit për punën e tyre të përkushtuar. Do të ishte mirë nëse më shumë njerëz do të viheshin në dispozicion për këtë punë vullnetare. Ne do të ishim të lumtur nëse vendosni ta bëni këtë punë vullnetare ose nëse njihni dikë që dëshiron të bëjë diçka për sigurinë e fëmijëve. Ju duhet të vendosni në dispozicion gjysmë ore në mëngjes para fillimit të shkollës çdo dy javë. Qyteti Dachau paguan **5.10 €** për këtë detyrë. **Ju lutemi regjistrohuni në sekretarinë e shkollës filllore Dachau-Ost për shërbimin e ndihmësve të rrugës së shkollës.**

9. Zona e pushimit

Zona e pushimit i përket ambienteve të shkollës dhe i nënshtrohet ndalimit të rreptë të pirjes së duhanit, i cili duhet të respektohet nga të gjithë prindërit dhe vizitorët. Gjithashtu ju lutemi të siguroheni që fëmijët tuaj të jenë të vetëdijshëm se rregullat e përcaktuara këtu zbatohen edhe pasditeve - ne kemi probleme të mëdha me mbeturinat që gjenden në oborrin e shkollës dhe me mbishkrime në muret e shkollës. Kjo ndodh kryesisht pasdite ose në orët e mbrëmjes. **Në ambientet e shkollës mund të hyhet vetëm me maskë.**

10. Plani i pushimeve:

Ju lutemi të keni parasysh planin e pushimeve të shkollës para se të planifikoni pushimet tuaja. **Theksoj shprehimisht se nuk lejohet mungesa e fëmijëve në shkollë para fillimit ose pas mbarimit të pushimit shkollor. Mungesa e pajustificuar e fëmijës në shkollë nënkupton një shkelje të ligjit të shkollimit të detyrueshëm dhe dënohet me gjobë.**

11. Gjërat e humbura:

E RËNDËSISHME: Ju lutemi etiketoni kutitë e drekës dhe shishet e pirjes me emrin dhe klasën e fëmijës tuaj. Poashtu etiketoni çantat e këpucët e sportit si dhe pantoflat e fëmijës tuaj.

Ju ose fëmija juaj do të gjejë gjëra e humbura në kutinë e gjelbër të grumbullimit në korridorin para sekretariatit. Në javën e fundit para pushimeve, sendet e humbura dhe të gjetura janë në korridorin që të çon në shkollën e mesme. Çdo gjë që nuk është marrë deri të premtën para fillimit të pushimeve do të hidhet në kosh të plehrave. Ju lutemi t'iu kërkoni fëmijëve tuaj ose ejani ju dhe hidhini një sy në kuti nëse diçka mungon - faleminderit!

12. Faqja e internetit:

www.grundschule-dachau-ost.de

Faqja e internetit do të aktualizohet vazhdimisht në ditët në vijim.

13. Kohët e mësimit

Ora e parë: 8:00 – 8:45
Ora e dytë: 8:45 – 9:30
Pushimi: 9:30 – 9:40
Ora e tretë: 9:40 – 10:25
Ora e katërt: 10:25 – 11:10
Pushimi: 11:10 – 11:30
Ora e pestë: 11:30 – 12:15
Ora e gjashtë: 12:15 – 13:00

14. Biblioteka e shkollës

Shkolla jonë ka një bibliotekë për nxënës. Fëmijët atje mund të huazojnë libra falas.

15. Pagesa e huazimit për leximin e lektyrave të klasës:

Ne marrim një tarifë huazimi prej 50 cent për nxënës për çdo lektyrë të klasës të siguruar nga shkolla.

16. Dosja e prindërve:

Ashtu si në vitet e mëparshme, prindërit e klasëve të para do marrin një dosje të informacionit të prindërve **përmes ESIS**. Dosja e prindërve përmban fillimisht informacionet më të rëndësishme në lidhje me fillimin e vitit shkollor. Duke nënshkruar fletën e kthimit ose duke u përgjigjur përmes ESIS, ju konfirmoni se e keni lexuar letrën dhe përmbajtjen e saj.

17. Rregulli i shkollës:

Ju lutemi bisedoni me fëmijën tuaj se si sillet të me përgjegjësi në klasë, korridor apo tualetet. **Në rast të ndotjes ose dëmtimit me dashje, prindërit apo kujdestarët ligjorë janë përgjegjës** dhe u kërkohet të vijnë në shkollë për pastrim ose punë riparimi.

Faleminderit për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj në këtë çështje!

18. Në shkollën tonë ka shërbim social të rinjve. Zonja Decker nga AWO Dachau punon së bashku me nxënës, prindër dhe mësues. Më shumë informacione mund të gjeni në faqen tonë të internetit.

19. Termine të rëndësishme: Mbarimi i mësimit në javën e parë për të gjithë: 11:10, nga e hëna, 20.09.2021, sipas orarit

1. Mbrëmje për prindër:

në orën 19:00 në klasën përkatëse

Klasa e parë: e mërkurë, 15.09.2021

Klasa e dytë: e hënë, 20.09.2021

Klasa e tretë: e martë, 21.09.2021

Klasa e katërt: e martë, 21.09.2021

Zgjedhja e këshillit të prindërve: e enjte, 30.09.2021 në orën 19:30.

Dita e prindërve: e martë, 16.11.2021 nga ora 16:00 deri në orën 19:00

- një ftesë e veçantë do të vijë në fillim të nëntorit –

Sinqerisht

Andrea Noha, Drejtoresha e shkollës

Carolyn Hausner, Zëvendës drejtoresha e shkollës